



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:143970
Datë: 13.05.2024
Numri i dokumentit: 05672952

PAKR.nr.176/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti i Krimeve të Rënda, në kolegjin penal të përbërë nga gjyqtarët Vaton Durguti, kryetar kolegj, Afërdita Bytyçi dhe Bashkim Hyseni, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bajram Rexhahmetaj, në çështjen penale kundër të akuzuarit D.B. nga P. Rr.”M.”, nr..., për shkak të veprës penale, Vrasje në tentativë nga neni 172, lidhur me nenin 28 të KPRK-së, duke vendosur në lidhje me ankesën e mbrojtëses së të akuzuarit D.B. av. B.K. të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.101/2023, i datës 28.12.2023, në seancën e kolegjit me datë 26.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e mbrojtëses se të akuzuarit D.B. av. B.K. ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.101/2023, i datës 28.12.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin, PKR.nr.101/2023, i datës 28.12.2023, të akuzuarin D.B. e ka shpallur fajtor për veprën penale, Vrasje në tentativë nga neni 172, lidhur me nenin 28 të KPRK-së, dhe e ka gjykuar me dënim me burg në kohëzgjatje prej tri (3) vite, duke i llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim nga data 28.06.2023 e deri më datë 28.12.2023.

I akuzuari është obliguar që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 100 €, në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguajë shumën prej 50 (pesëdhjetë) euro, të cilat është obliguar që t'i paguaj në afatin prej 30 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

Kundër këtij aktgjykimi ka parashtruar ankesë mbrojtësja e të akuzuarit D.B. av. B.K. për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që Gjykata Apelit e Kosovës, aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.101/2023, i datës 10.01.2023, t'a ndryshoj ashtu që të akuzuarit D.B. t'i shqiptoj një dënim më të butë me të cilin dënim do të arrihet qëllimi i dënimit.

Prokurori i Apelit me parashtrësën më shkrim, PPA/I.nr.170/2024, të datës 21.03.2024, ka propozuar që të refuzohet si e pa bazuar ankesa e mbrojtëses së të akuzuarit D.B. av. B.K. ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.101/2023, i datës 28.12.2023, të vërtetohet.

Konform nenit 390 par.1 të KPPK-së, u caktua dhe u mbajt seanca e kolegjit në të cilën prezantoi i akuzuari D.B. dhe mbrojtësja e tij, av. B.K. ndërsa nuk prezantoi i dëmtuari T. Sh. dhe as Prokurori i Prokurorisë së Apelit, edhe pse të njoftuar në mënyrë të rregullt gjyqësore për kohën dhe vendin e mbajtjes së seancës, andaj, seanca e kolegjit u mbajt konform nenit 390 par. 4 të KPPK-së, në mungesë të tyre. Mbrojtësja e të akuzuarit D.B. av. B.K. pasi që sqaroi disa pretendime ankimore mbështeti propozimin e parashtruar në ankesë, ndërsa i akuzuari D.B. mbështeti mbrojtësin e tij.

Gjykata e Apelit pasi që ka studiuar aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore të mbrojtëses së të akuzuarit, propozimin e Prokurorisë së Apelit, dhe duke analizuar shkresat e

lëndës në këtë çështje penale në vështrim të nenit 394 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale, gjeti se:

Ankesa nuk është e bazuar.

Pretendimet ankimore të mbrojtëses së të akuzuarit

Mbrojtësja e të akuzuarit D.B. av. B.K. në ankesë ka theksuar se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është tejet i lartë duke patur parasysh faktin se i dëmtuari nuk ka kërkuar dëmshpërblim. Se para lidhjes së marrëveshjes për pranim fajësie raportet e familjes së të akuzuarit me të dëmtuarin kanë qenë tejet të acaruar gjë që lidhja e marrëveshjes ka ndikuar në përmirsimin e ketyre raporteve. Është e saktë se gjykata vendosi në bazë të kushteve të ofruara me marrëveshje e cila u arritë para përmirsimit të raporteve. Pas gjykimit i njëjti është ballafaquar me sëmundjen e nënës së tij e cila si nanë vetëushqyese shumë vështirë e ka përballu faktin se fëmiju i sajë i cili kurrë nuk ka rënë ndesh me ligjin të ndiqet për një vepër kaq të rëndë penale. Andaj, duke patur parasysh këto rrethana si dhe faktin se i akuzuari në momentin e kryerjes së veprës penale ka qenë i moshës së re, i vetmi mbajtës i familjes, i gjendjes së dobët ekonomike, i pa punë, pendimin dhe premtimin se në të ardhmën nuk do të vije në konflikt me ligjin e po ashtu edhe faktin se i dëmtuari nuk ka parashtruar kërkesë për dëmshpërblim, kërkon nga Gjykata e Apelit që të akuzuarit dënimin e shqiptuar t'ia zvogëloj me shpresë dhe bindje se me dënimin zvogëluar do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së.

Gjetjet e Gjykatës së Apelit

Aktgjykimi i gjykatës së shkallës parë edhe pse nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin e shqyrtoi sipas detyrës zyrtare edhe në këtë aspekt konform nenit 394 par.1 të KPPK-së, dhe gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e as shkelje të tjera të cilat detyrimisht do të kushtëzonin prishjen e tij.

Po ashtu, me ankesë nuk kontestohet as gjendja faktike të cilën e ka vërtetuar gjykata e shkallës së parë, prandaj as në këtë aspekt çështja nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj Gjykate (në fakt as që ka mund të kontestohet aktgjykimi përkitazi me këtë bazë ankimore ngase i akuzuari ka pranuar fajësinë), kurse aktgjykimi u vlerësua vetëm në frymë të pretendimeve ankimore sa i përket vendimit për dënim.

Duke shqyrtuar çështjen përkitazi me vendimin për dënim, Gjykata Apelit, gjen se pretendimet ankimore të mbrojtësës së të akuzuarit për zbutje të dënimit, nuk janë të bazuara. Gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit ka vlerësuar të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69, 70,71 e 72 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit dhe me vlerësimin e të gjitha rrethanave rënduese dhe lehtësuese, gjykata ka pasur parasysh se secila prej këtyre rrethanave veç e veç janë vlerësuar në ndërlidhje me të gjitha rrethanat e tjera të cilat ndikojnë në matjen e dënimit. Në rastin konkret duke gjetur si rrethana rënduese shkallën e përgjegjësisë penale, motivin për kryerjen e veprës penale, shkallën e rrezikimit të vlerës së mbrojtur, duke pasur parasysh pasojën e shkaktuar dhe se kjo dukuri shpesh paraqitet në shoqërinë tonë, ndërsa si rrethana lehtësuese janë marrë pranimi i fajësisë gjatë arritjes së marrëveshjes, se është i moshës së re, rrethanat personale se është i papunë, i gjendjes së dobët ekonomike, i vetmi mbajtës i familjes, pendimi dhe premtimi se në të ardhmën nuk do të vijë në konflikt me ligjin e po ashtu edhe se i dëmtuari nuk ka parashtruar kërkesë për dëmshtëpërlim, prandaj gjykata me pranimin e marrëveshjes të akuzuarin e ka gjykuar sipas kushteve të ofruara me marrëveshje, me dënim me burg në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite, duke konsideruar se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit.

Një vlerësim të tillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa rrethanat e pretenduara në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk janë të asaj natyre dhe nuk kanë ndikim që të akuzuarit ti shqiptohet dënim tjetër nga ai të cilin i ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë, andaj, të gjitha këto rrethana sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj Gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Prandaj, kjo Gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit nga ana e Gjykatës së shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutor, dhe me intensitetin e rrezikimit apo pasojave të shkaktuara dhe se me të do të mund të parandalohet i akuzuari nga kryerja e veprave penale në të ardhmën, si dhe do të parandalohen personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Nga arsyet e sipërcekura, e në bazë të nenit 401 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për Krime të Rënda
PAKR.nr.176/2024, datë 26.04.2024

Bashkëpunëtori Profesional

Kryetari i kolegjit

Bajram Rexhahmetaj

Vaton Durguti

Anëtarët e kolegjit:

Afërdita Bytyçi

Bashkim Hyseni